



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Nr.620/ 21

621/2021

Në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2 dhe nenin 108/A të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-092, neni 4 Rregullat e paraqitjes së kërkesës për rishqyrtim pran autoriteti kontraktues, parashtrimi të ankesave pran OSHP-së, dhe vlera e tarifave të ankesave, si dhe nenin 17 paragrafi 3 i Rregullores së Punës së OSHP-së nr. 01/2020, me numër të protokollit 83/2020, pas shqyrtimit të ankesës së OE “Avni R Elshani B.I (Auto Kosova Petrol me seli në Suharekë me numër të protokollit 620/21 dhe ankesës së OE “Selami Elshani B.I (NTSH Flamuri 1979 me seli në Suharekë me numër të protokollit 621/21, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Shërbimet e zhvendosjes me merimangë dhe bllokimit të automjeteve në territorin e komunës së Suharekës” me numër të prokurimit: AP 624-21-3919-2-2-1 iniciuar nga AK Komuna e Suharekës , Kryesuesi i Sekretariatit të Organit Shqyrtues të Prokurimit z. Ardian Behra me datën: 07.09.2021 mori këtë:

VENDIM

- I. Hedhet si e pa lejuar** ankesa e OE “ Avni R Elshani B.I (Auto Kosova Petrol me seli në Suharekë me numër të protokollit 620/21 dhe ankesa e OE “Selami Elshani B.I (NTSH Flamuri 1979 me seli në Suharekë me numër të protokollit 621/21,

lidhur me aktivitetin e prokurimit “Shërbimet e zhvendosjes me merimangë dhe bllokimit të automjeteve në territorin e komunës së Suharekës” me numër të prokurimit: APAP 624-21-3919-2-2-1 iniciuar nga AK Komuna e Suharekës

- II. **ILEJOHET** autoritetit kontraktues – Komuna e Suharekës që të vazhdojë më tutje, me procedurat e prokurimit lidhur me aktivitetin e prokurimit: “shërbimet e zhvendosjes me merimangë dhe bllokimit të automjeteve në territorin e komunës së Suharekës” me numër të prokurimit: AP 624-21-3919-2-2-1 iniciuar nga AK Komuna e Suharekës, (nëse nuk ka ankesë tjetër).
- III. Ankesat e operatoreve ekonomik ankues nuk mund të shqyrtohet, pasi që të njëjtat nuk janë proceduar sipas nenit 108/A dhe 109 të LPP-së si dhe nenin 9 të Rregullat e paraqitjes së kërkesës për rishqyrtim pranë autoriteti kontraktues, parashtrimi të ankesave pranë OSHP-së, dhe vlera e tarifave të ankesave, operatoreve ekonomik ankues sipas nenit 31 pika 4, të Rregullores së Punës së OSHP-së, ju kthehet tarifa e ankesës.
- IV. **Obligohen**, OE ankues që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores të Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjnë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën iu bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Më datën 23.08.2021 Organi Shqyrtues i Prokurimit në sistemin elektronik ka pranuar ankesën e OE “Avni R Elshani B.I (Auto Kosova Petrol me seli në Suharekë me numër të protokollit 620/21 dhe ankesën e OE “Selami Elshani B.I (NTSH Flamuri 1979 me seli në Suharekë me numër të protokollit 621/21, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Shërbimet e zhvendosjes me

merimangë dhe bllokimit të automjeteve në territorin e komunës së Suharekës” me numër të prokurimit: AP 624-21-3919-2-2-1 iniciuar nga AK Komuna e Suharekës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit ka analizuar ankesat në fjalë dhe bazuar në verifikimin e shkresave të lëndës, në platformën e-prokurimi dhe sqarimet e dhëna nga KRPP rreth funksionit të sistemit e-prokurimit rezulton se këto dy ankesa duhet hedhen si të pa lejuar.

Organi Shqyrtues i Prokurimit sqaron se sa i përket ankesës me nr. 620/21 të dt. 23.08.2021, të parashtruar nga OE- “ Avni R Elshani B.I (AutoKosova Petrol) ” për aktivitetin me titull “ Shërbimet e zhvendosjes me merimangë dhe bllokimit të automjeteve në territorin e komunës së Suharekës”.

- Letra Standarde është ngarkuar me datën 05.08.2021,
- Kërkesa për rishqyrtim është proceduar me dt. 10.08.2021,
- AK ka kthyer përgjigje në kërkesën për rishqyrtim me dt. 11.08.2021
- Ankesa në OSHP është bërë me datën 23.08.2021

Sa i përket verifikimit në e-prokurim si dhe në vendimin e AK-së konstatohet se OE Ankues nuk kanë dorëzuar ofertën e tyre fare lidhur me këtë aktivitet të prokurimit ku njëkohësisht e cekin në ankesë se nuk kanë mundur të ngarkojnë ofertën për shkak të problemeve me sistemin e platforme.

Sa i përket ankesës me nr. 621/21 të dt. 23.08.2021, të parashtruar nga OE- “ Selami Elshani B.I (NTSH Flamuri 1979) ” për aktivitetin me titull “ Shërbimet e zhvendosjes me merimangë dhe bllokimit të automjeteve në territorin e komunës së Suharekës”, sqarohet si më poshtë:

- Letra Standarde është ngarkuar në sistemin elektronik e-prokurimi me datën 05.08.2021,
- Kërkesa për rishqyrtim është proceduar me dt. 10.08.2021,
- AK ka kthyer përgjigje në kërkesën për rishqyrtim me dt. 11.08.2021
- Ankesa në OSHP është bërë me datën 23.08.2021

Sa i përket verifikimit në e-prokurim si dhe në vendimin e AK-së konstatohet se OE Ankues nuk kane dorëzuar ofertën e tyre fare lidhur me këtë aktivitet të prokurimit ku ankuesit pretendojnë, se nuk kane mundur te ngarkojnë ofertën për shkak te problemeve me sistem në platformë.

Organi Shqyrtues i Prokurimit për te vërtetuar, se a qëndrojnë arsyet e dhëna nga OE –të, se nuk kane mundur ti ngarkojnë ofertat e tyre për shkak te problemeve me sistem në platformë e-prokurimit, me datën 07.09.2021 , ka kërkuar sqarim nga KRPP-së: Sa i përket ankesave me nr. prot.620-621/21 te parashtruara ne OSHP nga OE- Avni R Elshani Bi(Auto Kosova Petrol) si dhe nga OE-Selami Elshani BI (NTSH Flamuri 1979) , për aktivitetin me titull ‘ Shërbimet e zhvendosjes me merimangë dhe bllokimit te automjeteve ne territorin e Komunës se Suharekës, të iniciuar nga AK- KK Suhareke, kërkojmë qe te na njoftoni se a ka funksionuar platforma (a ka pasur problem) sistemi i E-prokurimit gjate dorëzimit te ofertave te Operatoreve Ekonomik te përmendur si me larte.

KRPP- me daten:07.08.2021, kthen përgjigje:

Te nderuar,

Referojuni pergjigjes ne attachment.

Lidhur me shkresën e OE “Auto Kosova Petroll” rreth pamundësisë se dorëzimit te ofertës ne aktivitetin e prokurimit me Nr. 624-21-3919-2-2-1, si shërbim I helpdeskut ju informojmë qe me date 15.07.2021 nuk kemi patur te regjistruar ndonjë problem teknik te sistemit te prokurimit elektronik qe ka ndikuar ne pamundësi të dorëzimit te ofertave nga cilido OE. Për rastin konkret, përfaqësuesve te OE nëpërmjet linjës telefonike i është dhënë asistenca teknike nga shërbimi I helpdeskut për mënyrën e krijimit te grupit te OE apo hapat qe duhet ndjekur, derisa pamundësia e përgatitjes dhe dorëzimit te ofertës ka qene në varësi te veprimeve te përdoruesve te OE.

Prandaj duke u nisur nga sqarimet e dhëna si më lart OSHP konstaton se ankesa e parashtruar në OSHP nga OE “Avni R Elshani B.I (Auto Kosova Petrol me seli në Suharekë me numër të protokollit 620/21 dhe ankesën e OE “Selami Elshani B.I (NTSH Flamuri 1979 me seli në Suharekë me numër të protokollit 621/21, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Shërbimet e zhvendosjes me merimangë dhe bllokimit te automjeteve në territorin e

komunës së Suharekës” me numër të prokurimit: AP 624-21-3919-2-2-1 iniciuar nga AK Komuna e Suharekës, hedhen si të pa lejuara sepse ankuesit nuk kanë marr pjesë fare në aktivitetin e prokurimit në fjalë, dhe KRPP ka sqaruar se platforma elektronikë e e-prokurimit nuk ka pasur asnjë problem teknik që ju ka pamundësuar operatoreve ekonomik të dorëzojnë ofertat e tyre në afatin për dorëzim të ofertave për aktivitetin e prokurimit në fjalë.

Kryesuesi i Sekretariatit të OSHP-së, duke u bazuar në atë që u tha si më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t’i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.



Vendimi t’i dorëzohet:

1x1 AK – Komuna e Suharekës

1x1 OE “Avni R Elshani B.I (Auto Kosova Petrol me seli në Suharekë

1x1 OE “Selami Elshani B.I (NTSH Flamuri 1979” me seli në Suharekë

1x1 Arhivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së